



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Muaji SHTATOR mbajtur sot me datë
29/09/2023 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici, Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Erald Carciu, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Alfrida Shahini.

Mbledhja drejtohet nga zv/Kryetari i Këshillit znj. **Arnilda Dakare**.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projektvendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjësit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projektvendimet dhe relacionet, merr pjesë Kryetari i Bashkisë.

A. Dakare: Pershendetje, duke qene se kurumi eshte plotesuar mbledhjen e deklaroj te hapur, para se te vazhdoj me rendin e dites, do te bej kekresen te fusim ne rend dite edhe disa materiale:

1-Per faljen e tarifes se varrimit te te ndjeres znj. Matilda Xhorxhi Salla.

2-Per miratimin e kalendarit te konsultimeve publike draft projektit te buxhetit afatmesem 2024-2026.(PBA)

Kemi edhe disa pika kerkesa / ankesa te cilat do i trajtojme te te tjerat.

Jeni dakort ti fusim ne rend dite?

***Miratohet futja e materialeve te mesiperme ne rend dite me 14 Vota PRO**

Votojme Rendin e dites?

***Miratohet rendi i dites me 14 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini



zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 1

1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Gusht 2023(fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici,Roland Mimini,Kujtim Brahimi,Erald Carciu,Arnilda Dakare,Dalip Hazizaj,Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi,Alfrida Shahini.

Pergj.Ndh.Ek: Per muajin Gusht kemi 37 familje per perfitim ekonomik te cilat jane perzgjedhur nga sistemi,nese keni pyetje?

A.Dakare: Votojme?

***Miratohet pika e 1 e rendit të ditës me 14 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Adresa: Sheshi "Kamber Dermeshi" Bulevardi, "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com



Çështja 2

2- Për miratimin e projektit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 për bashkinë Gramsh të rishikuar.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici, Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Erald Carciu, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Alfrida Shahini.

Dr. Ekonomik: Ben shpjegime lidhur me relacionin. është një material i futur në muajin qershor, kjo është faza e tretë, e cila është për perfundime/sygjërime. Në dokument janë gjithë gjerat që janë miratuar në muajin qershor, përveç gjimnazit që kaluam. Ky është një parashikim, buxheti final është në dhjetor, ku mund të jepni sygjërime, ju ftoj ta votoni.

K. Brahimi: Janë planifikuar berja e shkalleve në lagjen Llapushaj që në 2022, pse ende nuk janë nisur punimet?

Dr. Ekonomik: Për pjesën e shkalleve ka mbaruar procesi i tenderimit, pritet të fillojë puna.

A. Shahini: Flet për mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë, pame që rruga e fshatit Sotire dhe liqenit të Dushkut do behen me fondet e Qeverisë dhe leket do shkojnë në tre projekte të tjera. Komisioni propozoi: Sistemimin e lagjes Pishaj, sistemimin e lagjeve për rastet e emergjencave, dhe pjesa e parkimeve në qytet. Nuk kemi kundërshtim për projekt buxhetin si komision.

K. Cala: Nuk jam dakort me drejtorin ekonomik, sepse ky është p/buxhet dhe duhet ta shikojmë me seriozitet jo vetëm ta miratojmë. Ky buxhet për mendimin tim nuk mjafton për qytetin tonë me duket shumë pak. Shpresa mbetet të granet e qeverisë. Sipas pasqyrave 41% të këtij buxheti e ze administrata, me duket se kemi më tepër se duhet administratë, sygjëroj të rishikohet. Te projektet duhen bërë ato me imediatet. Te disa projekte shoh shumë të mëdha.

(Vjen në mbledhje znj. V. Verushi)

***Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë.**

K. Bashkise: Ate e përcaktojnë inxhinieret, projektet e propozuara nuk kanë as date fillimi e as date mbarimi, në do i diskutojmë nëpër degjësa e këtu në këshill me vone do të vendosim se kush do të ketë prioritet. Për kanalet vaditese në Mashan, është viti 2 që behet. Për ujën e pijshëm që është emergjencë në fshatra, kemi 3 projekte në konkurim të Akum, jemi në gare. Disa projekte nuk përballohen me buxhetin e bashkisë, them se më shumë se gjysmën do kërkojmë ndihmë nga Qeveria.

Administrata po e ben me se miri punën e saj, për gati 23-24 ditë ka bërë 4 projekte të mëdha. Në do i shohim bashkë projektet/investimet për të përcaktuar prioritetet.

E. Carciu: P/buxhetin s' duhet ta shohim si numër, ta shikojmë si prioritet për të ardhmen tonë. Prioritetet të jenë bashkëpunimi ynë. Dua të merren parasysh sygjërimet që kemi bërë në komision.

F. Cekrezi: Duke qenë se është PBA respektimi i ligjit dhe konsultimi publik duhet respektuar.

A. Dakare: Votojmë?

***Miratohet pika e 2 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

2 Vota Kunder: K. Cala, V. Verushi

Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 3

3- Për miratimin e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici, Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Erald Carciu, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Alfrida Shahini, Valbona Verushi.

Relatohet nga përgjegjësja e sektorit material i paraqitur.

F.Cekrezi: Lidhur me dhenien me qira, edhe ky material i kalon Komisionit të Financave, në material pse nuk ka kërkesa me emer të saktësuar?

Pergj.Sekt.pyjor: Në fillim hidhet në tenderim, kalon në parim njëherë.

F.Cekrezi: Sa kërkesa janë nga qytetaret?

Pergj.Sekt.pyjor: Vetëm një kërkesë për momentin, ligji citon se me marrjen e kërkesës së parë bashkia vihet në levizje.

K.Cala: Për mua informacioni është shumë i saktë, kushdo që kërkon toka me qira duhet të jepen në baze të konkurrencës.

A.Dakare: Kalojmë në votim?

***Miratohet me 15 Vota PRO pika e tretë e rendit të ditës.**



Sekretar i Këshillit

Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit

Arnilda Dakare

Çështja 4-5
(Shqyrtohen sebashku keto dy pika)

4-Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik për ndërtim dhe operim të HEC “Grabova 1”, nga shoqëria “ Grabova Hydropower” shpk.

5- Dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik për ndërtim dhe operim të HEC BLINETA nga shoqëria “ ERA HYDRO” shpk.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici,Roland Mimini,Kujtim Brahimi,Erald Carciu,Arnilda Dakare,Dalip Hazizaj,Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi,Alfrida Shahini,Valbona Verushi.

Dr.Sherb.PyJOR: Kjo ka te beje vetem me ndryshimin e vendimit,duhet saktësuar ne vendim nr.parceles, pra behet fjale per plotesim(nr.ngastres), 2 shifrat e raportit teknik duhen vene ne vendim, sic e kerkon ministria.Per te dy materialet eshte e njejta gje

A.Dakare: Kalojme ne votim? Te dy materialet, pika 4 dhe 5?

***Miratohet me 12 Vota PRO pika e 4 e rendit te dites.**

***Miratohet me 12 Vota PRO pika e 5 e rendit te dites.**

Votuan KUNDER per te dy materialet : E.Carciu, K.Cala,D.Hazizaj.



Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 6

4- Të tjera, Kërkesa nga Qytetarët.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici, Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Erald Carciu, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Alfrida Shahini, Valbona Verushi.

Sek. Këshillit: Lidhur me kërkesat e qytetarëve dhe ankesat që janë bërë sa i përket zgjedhjeve të Kryesve në fshatra, do të trajtohen me parë në komisionet përkatëse e më pas do të diskutojmë në këshill (ky mendim ishte unanim i gjithë këshilltarëve prezent).



Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 7

7- Per miratimin e kalendarit te konsultimeve publike draft projektit te buxhetit afatmesem 2024-2026.(PBA)

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici, Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Erald Carciu, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Alfrida Shahini, Valbona Verushi.

A.Dakare: Vazhdojme me materialet qe futem jashte rendit te dites?

Sa i perket kalendarit te konsultimeve publike behet fjale per nje kalendar (datat e te cilit mund te ndryshojne ne vazhdim), ku do te zhvillohen konsultimet me publikun, grupet e interesit sa i perket buxhetit, ne cdo NJA, lagje etj. Do te jemi ne bashkepunim per te marre pjese si pjese e finances se administrates se bashkise ashtu edhe keshilltare te ndare sipas deshires ne zonat ku do te shkojme. Votojme?

***Miratohet me 15 Vota PRO pika e 7 e rendit te dites.**



Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 8

8- Per faljen e tarifes se varrimit te te ndjeres znj.Matilda Xhorxhi Salla.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Kodhel Cala, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Visarion Bici, Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Erald Carciu, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Alfrida Shahini, Valbona Verushi.

A.Dakare: Lidhur me materialin tjetër, sic shpjegohet ne relacion do falet tarifa e varrimit, shkak i pamundesise ekonomike dhe tragjedise se ndodhur qe i mori jeten para kohe te rese se ndjere, jeni dakort? Votojme?



Sekretar i Këshillit

Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit

Arnilda Dakare